

UDHËZIM
Nr.30, datë 29.7.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.8, DATË 6.5.1999 “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, NË ZBATIM TË
VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.194, DATË 22.4.1999**

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.194, datë 22.4.1999 “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.617, datë 21.12.1999 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.596, datë 13.11.2000 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.194, datë 22.4.1999 “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, për interpretim më të drejtë dhe të unifikuar të vendimeve të Këshillit të Ministrave më lart,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr.8, datë 6.5.1999 “Për pagat e punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, në paragrafin e I, pika “1” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Paga e grupit sipas nivelit arsimor të kërkuar nga vendi i punës:

- GRUPI I I “1”

ME DIPLOMË TË SHKOLLËS SË LARTË PËR MËSUESI, POR QË JAPIN MBI 30% TË NGARKESËS MËSIMORE LËNDË TË PROFILIT TË TYRE. ME DIPLOMË TË SHKOLLËS SË LARTË PËR MËSUESI, QË JAPIN MËSIM NË KLASAT KOLEKTIVE TË CIKLIT TË LARTË. ME DIPLOMË TË SHKOLLËS SË LARTË PËR DEGËT FIZIKE E BIOLOGJI DHE JAPIM MËSIM NË KLASËN E V-TË, DY MËSUES PËR DY KLASË.

- GRUPI I II “2”

ME SHKOLLË TË MESME PEDAGOGJIKE:
ME SHKOLLË TË MESME PROFESIONALE KU FITOHET SPECIALITETI PËR MËSUESI.
DIPLOMË MBI SHKOLLËN E MESME.
PUNONJËSIT MËSIMORË TË CILËT KANË MBARUAR TË PAKTËN 2 VITE AKADEMIKE TË SHKOLLËS SË LARTË.
TË GJITHË PUNONJËSIT MËSIMORË ME DIPLOMË TË SHKOLLËS SË LARTË PËR MËSUESI, QË JAPIN MË PAK SE 30% TË NGARKESËS MËSIMORE ME LËNDË JASHTË PROFILIT.

2. Shtesa për vjetërsi në punë në profil.

Paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë:

Vjetërsi në punë në profil, do të konsiderohet periudha e punës së kryer në ato vende pune të cilat përcaktohen në udhëzimin nr.2, datë 10.1.2008 “Për vjetërsinë e punës në arsim”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Udhëzimi nr.16, datë 3.10.1991 “Mbi vjetërsinë e punës në arsim për efekt atestimi”, shfuqizohet.

3. Për mësuesit që punojnë larg vendbanimit

Për një zbatim më të drejtë të lidhjes nr.3 “Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar që punojnë larg vendbanimit”, të veprohet si më poshtë:

Për paragrafin 1.

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 1500 lekë në muaj, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 4375 lekë në muaj.

Çdo fillim viti mësimor të evidentohen punonjësit mësimorë që punojnë larg vendbanimit nëpërmjet vërtetimeve të pushtetit vendor (nga kryeplaku dhe kryetari i komunës ose bashkisë).

Për punonjësit mësimorë që e kryejnë rrugën me transport të siguruar nga DAR/ZA-at, masa e shpërblimit mujor për largësi, të jetë sipas distancës në kilometra.

Në rastet kur nuk mund të sigurohet transporti për mungesë infrastrukture, masa e shpërblimit të përcaktohet në raport me largësinë dhe vështirësinë e rrugës.

Në rastet kur mësuesi ndryshon vendbanimin me dëshirën e tij dhe vazhdon të punojë në të njëjtën vend pune, përfiton shpërblimin për largësi vendbanimi vetëm kur DAR/ZA-at nuk kanë mundësi për zëvendësimin e tij.

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm dhe Drejtoria e Planifikimit Buxhetor.

III. Ky udhëzim hyn në fuqi me fillimin e vitit mësimor 2008-2009.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo